

INTERVISTË ME XHELADIN KASTRATIN

Prizren | Data: 30 maj, 2018

Kohëzgjatja: 38 minuta

Të pranishëm:

- Xheladin Kastrati (I intervistuari)
- Irvin Jaha (Intervistuesi)
- Elmedina Arapi (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Irvin Jaha: Mund ta bëni një prezantim nga ana juaj, si quheni, prej nga vini?

Xheladin Kastrati: Para së gjithash ju falenderoj që keni ardhë, mirë se keni ardhë te unë edhe falemnerës që jeni mundu pak për me qitë pak punën teme në selamet, me pa dikush çka kam punu çka s'kam punu e tjera.

Unë jam Xheladin Kastrati, i lindur në Prizren me 1937. Shkollën fillore e kom kry në Prizren vitet, deri në vitet '54 qashtu, mandej jam regjistru në shkollën e mesme të muzikës e cila ka vazhdu për mu deri në vitin '59. Në vitin '59 diplomova shkollën e mesme të muzikës dhe me dekret të komitetit të asaj kohe u punësova në Suharekë, se ishte qashtu rregulla e shtetit edhe Kuvendit Komunal që nuk mundesh me konkuru kur t'dush ti po ku t'dojnë ata edhe shkova në Suharekë me punu edhe punova shumë i knaqun. Seftë fillova me punu në Suharekë, përveç punës teme si pedagog, aty si arsimtar i muzikës e formova dhe korin e shkollës, që kurrë Suhareka në atë kohë s'kish pasë kor, e formova korin me të cilin me sukses e fitum vendin e tretë për herë te parë në garat e Kosovës të asaj kohe, Krahinës Autonome i thojshin.

Po, e fitum vendin e tretë, festivali u zhvillu në Prizren edhe kështu metëm të kënaqun. Në Suharekë deri me vitin, n'fund të vitit '60-'61 punova mandej shkova ushtar dhjetë muaj, kur jam kthi prej ushtrie kom konkuru n'Prizren me punu në shkolla fillore mirëpo jam pranu në shkollën "Mustafa Bakija", po ni drejtor që e kam pasë n'shollë t'muzikës ai m'takoi edhe m'tha, "Ku je, ku po shkon?" Thashë e mora vendimin se do punoj në shkollën "Mustafa Bakija", kështu tha, "Jo, prej nesër ke me punu në Shkollë Normale". Unë meta i befasum edhe hajt e ndëgjova shkova me punu në Shkollë Normale, boll me frikë sepse isha fëmijë atëhere, me të thonë të drejtën, njëzet vjeç e maturantat ishin t'zhvillum e tjera. Mirëpo, puna m'shkoj shkëlqyshëm, në Shkollë Normale kam punu dhjetë vjet, aty kom dhonë dy orë muzikë instrumentale në javë edhe dy orë muzikë vokale, domethonë katër orë muzikë kanë pasë nxanësat në javë...Katër orë muzikë, vokale dy, instrumentale dy.

Irvin Jaha: Në shkollë normale?

Xheladin Kastrati: Edhe kom dhonë mësim edhe shqiptarëve edhe turqve, kurse serbëve ju kanë dhonë profesorët e tyne. Në klasa ka pasë 35-40 nxanësa, të gjithë kanë pasë instrumentet e veta, mandolinat. Mandolinat i kom akordu unë për tri minuta 35 mandolina edhe u formu... çdo orë ka pasë orkestër mrenda në klasë, jo një zërshe, po dy zërshe. Edhe femnat edhe meshkujt me... Me ni entuziazëm të shkëlqyeshëm kanë punu edhe disiplina ka qenë e përsosun, në nivelin ma të lartë të mundun. Kështu kam vazhdu dhjetë vjet, mirëpo kjo është puna pedagogjike e mësimi në klasë, jashtë klase e formova edhe orkestrën popullore që mershin pjesë të gjitha konfesionet edhe serbët edhe shqiptarët edhe turqit, edhe e bojshim atë programin e përbashkët. Kemi pasë edhe folklorin, i hatashëm folklori i shkëlqyshëm u konë në Shkollë Normale.

E përveç të gjitha ktyne, formova korin e Shkollës Normale, i cili ka numëru tetëdhjetë e pesë anëtarë, prej të gjitha kombeve që kanë ekzistuar në shkollë, se shkolla atëherë ka numëru dy mijë e pesë qind nxanës. Drejtori i shkollës ka qenë ni serb, Rajko Radojeviq në atë kohë edhe Hasan Opoja ka qenë zvendës i tij. Kështu që unë provat e korit i kom majtë prej orës tetë të mbramjes deri në dhjetë të mbramjes, por fati jem i mirë se këta të dy, drejtori me gjithë zvendësin, gjithmonë ma kanë përcjellë punën edhe m'kanë ndihmu tu më ardhë shpeshherë në prova mos me m'lonë vetëm ose fëmijët si fëmijë edhe në mbramje, nata... Falemnderës edhe prej prindëve që kanë pasë besim me na i lëshu fëmijët me ardhë deri në ora dhjetë të mbramjes në prova.

Po ajo punë u pagu për së tepërmi, se me korin e Shkollës Normale të Prizrenit e kom zonë tri herë vendin e parë në republi... në garat republikane. Një herë në Krushevc herën e parë vendin e parë, Negotin herën e dytë, Kragujevc herën e tretë edhe erdh puna bile nëqoftëse keni nevojë m'i pa edhe këto diplomat jom... Jom zgjedhë si dirigjenti më i mirë i festivalit, prej tridhjetë e pesë ansambleve që kanë qenë aty në vendin e parë por edhe dirigjenti ma i mirë, e kom diplomën. Diplomat që i kam marrë personale ato edhe të shkollës edhe për mu. Kështu... erdh puna me e përfaqësu na Serbinë në Kroaci, merrni me mend, prej tridhjetë ansambleve mbarë Serbisë, na shqiparët e serbët e turqt që jemi konë qaj kori jonë tetëdhjetë e pesë anëtarë, kemi shku e kemi perfaqsu Serbinë në Zagreb, edhe kemi fjetë në hotelin "Internacional" ku ka fjetë edhe në atë kohë edhe Titoja, secili anëtar ka pasë dhomën e vet. Edhe në Zagreb e zumë vendin ma të mirin, "Uuuu", mbet i fascionum krejt populli që na ndëgjun, shqiptarët me ardhë prej Prizrenit edhe me këndu e me, me, me kenë ma t'mirët në festival. Po çka bon, pse u bo kjo, një një moment i çuditshëm është, unë s'e kom ditë që në gjuhën shqipe ekziston himni i Kroacisë.

Ky libër, këtë libër, këtë këngë në librin e vet e ka bo Kolë... Pitër Shiroka, e ka përkthi prej koratishtës në shqip edhe ai libër ekziston sot e asaj dite. Unë edhe e kam marrë atë se është katër zonëshe kënga, e kom ekzekutu. Unë nuk e kom ditë, kur e pash populli u çu në kamë. Nuk e morra vesh pse u çunë në kamë, kur dikush ka ardhë edhe m'ka prekë pantollët thanë, "Edhe niherë, te lutem", t'u kajtë, publiku t'u kajtë, "Edhe niherë, aman a bon edhe një herë", atëherë e morra vesh se qenka hymni i Kroacisë, "O atdhe i im i dashtun", e ka kënga emrin.

Prej Shkollës Normale, mandej vazhdova në '71-shin shkova në gjimnaz me punu, në gjimnaz ka qenë drejtor Daver Mashkulli, edhe shok e kom pasë, edhe muhabet kom pasë edhe shumë respekt ndaj meje se m'pat' dalë zani mu si dirigjent e si punëtor i madh i koreve e tjera, e tjera... E formova edhe në gjimnaz korin, që ky kori është i shkollës, i gjimnazit, ky këtu. Kurse ky kori këtu që po e shifni është kori që ka zonë tri herë vendin e parë në krejt Serbinë, kori i Shkollës Normale, e ky është kori i gjimnazit.

Edhe këtu janë nxanësat shqiptarë, turq edhe serbë. E në gjimnaz kam dhonë edukatë muzike, histori muzike, tonë gjimnazin, edhe serbëve, edhe shqiptarëve edhe turqve, secili në gjuhën e vet edhe jam nda shumë i kënaqun mirëpo këtu punova nja dy vjet, me rastin e njëzetë e pesë vjetorit të formimit të gjimnazit atëherë e bomë ni koncert në, në Shtëpinë e Kulturës në Prizren edhe aty formova ni orkestër popullor, me këngë popullore shqipe, turke, serbe edhe me këtë kor, qe ky kor është i asaj dite që kanë ekzekutu nxanësat e gjimnazit... Mas meje mandej u... unë shkova në shkollë të muzikës se erdhën e më lutën me shku atje, boll me frikë jom shku edhe në shkollë të muzikës sepse u duke me dhonë [mësu] instrument violinën, e aty ishte edhe profesori jem që m'ka dhonë mu violinë prandaj pak ish nifarë frike, thojsha para profesorit tem me dhonë unë violinë nxanësave. Mirëpo shumë mirë më shkoi puna edhe në shkollë të muzikës, tridhjetë e pesë vjet kam punu, deri më 2008-tën...

Irvin Jaha : Si ju ka lindë dashnia ndaj muzikës, keni pasë gjithmonë...

Xheladin Kastrati: Unë drejtë me të thonë, kur e kreu shkollën fillore kom pasë dëshirën me shku me studiu medicinën mirëpo ishim të vobekët na, unë e kisha veç nanën edhe ni vëlla, nuk kishim të ardhuna. Atëhere u detyrova me shku me ni shkollë në Prizren, shkollë në Prizren ma s'miri ish me shku në shkollë të muzikës edhe shkova, atëhere ka qenë drejtor Lorenc Antoni, ndjesë pastë, edhe kom marrë pesëshe në provim pranues, që me marrë te Lorenc Antoni pesëshe ka qenë *mesele* [turiqisht - tregim] ajo punë, mirëpo...

Shkollën deri në vitin e tretë e të katërt serbisht e kemi pasë ma tepër, një landë e kemi pasë shqip veç, gjuhën shqipe, e këto tjerat janë konë serbisht, histori, historia e muzikës e tjera, e tjera, serbisht. Me të kryme të shkollës muzikës mandej u detyrova edhe shkova e kreu edhe shkollën e lartë pedagogjike në Prishtinë edhe kështu vazhdova me dhonë mësim në shkollë të muzikës në Prizren. Prizreni është shumë interesant. Prizreni është me të vertetë e kanë gjetë që kanë thonë është kryeqyteti historik edhe me të thonë drejtë edhe kryeqyteti i kulturës së Kosovës është Prizreni.

Në Prizren ke pasë shkollën e muzikës, në Prizren ke pasë Shkollën Normale, në Prizren shkollën e medicinës, në Prizren ke pas te gjitha kombet kanë pasë shoqnitë e veta, "Dogru Yol"- ka pasë turqit, shqiptarët e kanë pasë "Agimi"-n, serbët atë.. "Buducnost"-in e tjera, e tjera, kshtu që Prizreni është burimi i kulturës kosovare. M'vjen keq me thonë, veç kur Prizreni ka qenë emën për kulturë të Kosovës, Prishtina nuk është ni. Prishtina ka qenë për neve katund (qeshë) po këtu është burimi. Po ju them të vërtetën, po do të dal ma vonë me ju arsyetu këtë fjalë temen që e thashë...

Irvin Jaha: E përmendët... E përmendët "Agimi"-n, a keni qenë të kyçun në Shoqërinë Kulturore Artistike "Agimi"?

Xheladin Kastrati: Në shkollë të muzikës përveç qe e kam dhonë instrumentin tem, prej vitit..Si nuanës i shkollës muzikës prej vitit 1958 jom konë këtu në shoqni të "Agimi"-t me i ra violinës në orkestrën popullore edhe unë me sukses fillova me u kuptu në shoqni aty kështu që ka vitet e '60-ta veq isha anëtar i pjekur për me hi në orkestër ku hypshin edhe para publikut me dalë e tjera.

Kështu, unë ma vonë, ma vonë u bona edhe udhëheqës i disa aktiviteteve në shoqëri të "Agimi"-t po do flasim pak ma vonë ato... Sa për shkollën e muzikës deshta me ju thonë edhe niher m'u kthy aty me mësimin e violinës pata sukses mjaft mirë, kom edhe mirënjohje nga kolektivi i shkollës muzikës, mirënjohjet nga kolektivi i gjimnazit, mirënjohje nga shkolla normale, me të thonë të drejtën e Zotit, qaq kam mirënjohje sa edhe unë nuk jom i rond aq sa kom mirënjohje (qeshë), por po flas kështu po më vjen keq që ju thashë po nuk po bohna modest mirëpo ato po tregojnë se këtu janë, sa që me ju thonë të vërtetën e kam edhe enciklopedinë e muzikës që është e botume në Kroaci, në të cilën isha edhe unë që s'e kom ditë se unë jam ne enciklopedi ku shkrun se, "Xheladin Kastrati, arsimtar i muzikës i Shkollës Normale të Prizrenit i cili disa herë me korin e Shkollës Normale e ka zonë vendin e parë në Serbi"... Këtu shkrun. E këtu ni profesor i jem pat' thonë, "Mere se ti je në të". Unë s'e kom ditë si emën mandej kur e morra e pashë se jom në këtë enciklopedinë e muzikës jugosllave, "Enciklopedia Jugosllave".

Irvin Jaha: E botune në Kroaci?

Xheladin Kastrati: Po, e. Po, po, në Kroaci e botume, e botume në Kroaci. Kshtu që me shkollën e muzikës për të cilën thashë pak më parë pata sukses sepse edhe nuanësat e shkollës muzikës kanë

marr shumë herë pjesë në festivalet nëpër Serbi, e në ato festivale i kom çu edhe unë nxanësat e mi, bile kom edhe mirënjohje që kom marrë vendin e dytë a vendin e tretë a.... Veç vendin e parë s'kom mujtë me ata me e marr kurrë, por vendin e dytë e tretë e kom marr sa herë qe kom shku.

Irvin Jaha: A keni qenë të ... Pasi që përmendët që keni marrë pjesë në festival nëpër Serbi, a keni qenë të diskriminim nëse ke qenë shqiptar me marr pjesë në festivale?

Xheladin Kastrati: Në festivalin e?

Irvin Jaha: Në Serbi në përgjithësi ose në Jugosllavi, a ju kanë shiku me ni sy tjetër?

Xheladin Kastrati: Jo, jo, jo na kemi shku edhe jemi konë shumë mirë të pranum, pa marrë parasysht kurrë nuk është përmendë kombi e kombësia e tjera, e tjera. Kudo që kemi shku... Merreni me mend jonë metë të fascionum njerëzit kur jom ardhë unë prej Serbie me vendin e parë, ka dalë kryetari i komunës me krejt stafin e vet me na pritë kur kemi zbritë prej trenit, se atëherë me tren jemi kthi prej Krushevcit, gjithashtu edhe prej Negotinit me tren. Kryetari i komunës ka dalë me na pritë në Shadërvan me lule me ovacione e tjera, e tjera. Na kemi pas... unë po të them kam fitu ni reputacion shumë të madh në atë kohë, mirëpo edhe organizimi ka qenë krejt tjetër se në shkolla tash jo shkolla fillore e mesme e ulët e mesme e të... Atëherë e dishim shkolla fillore, shkolla e mesme edhe gjimnazi e tjera, e tjera ... E tash janë hupë ato regullat e asaj kohe.

Nuk e di a ju intereson prapë për shkollën e muzikës? Po shkolla e muzikës ni burim, ni burim aq i randësishëm për trevën, për Kosovën në përgjithësi saqë njeriu mbetet pa tekst me bo me hi me analizu këto. Pse? Krejt çka ka kulturë të muzikës, burimin e kanë në Prizren. Shkolla e muzikës e Prizrenit osht' burimi i të gjitha aktiviteteve muzikore në Kosovë, ma vonë ato tash janë çelë ma vonë mirëpo këtu është, po them, burimi.

Shkollën e muzikës e ka kriju Lorenc Antoni. Lorenc Antoni ka vlerë të madhe kulturore edhe shpirtërore për Prizrenin. Lorenc Antoni është nipi i Nënës Terezë. Ai ka jetu dhe ka vepru në Prizren. Ai e ka formu korin e Prizrenit, korin e parë në Prizren në kishën e Prizrenit e ka formu korin. Aty ka fillu edhe orkestri pak a shumë edhe prej atyhit dalin e formojnë shoqërinë kulturore artistike "Agimi", ku është "Agimi" tash, jo në këtë ndërtesë po tjetër kund, po "Agimi" i Prizrenit po mendoj. Lorenc Antoni përveç se që ka qenë dirigjent i parë i korit, ai e ka formu edhe shkollën e muzikës, të parën në Prizren.

Ai i ka pranu nxanësat, te ai kemi hy në provim pranues edhe ka mbledhë arsimtarë ku janë ata ma t'mirët, nxanësat ma të mirë që kanë pas dikur shkollën e mesme aty i ka nalë për veti për me dhonë mësim. Prej shkollës muzikës gjeneratat e para kanë shku me studiu në Beograd se s'ka pasë në Kosovë as shkollë të naltë, as Akademi. Kështu që një gjeneratë e madhe e Prizrenit ka shku në Beograd me studiu, si janë Mark Kaçinari, ky Krist Lekaj, Shefqet Kazazi, Sevime Gjinali e tjera. Edhe krejt këta kur e kanë kry Akademinë e Beogradit, kanë ardhë në Kosovë edhe e kanë çelë Akademinë e Kosovës. Këta e kanë formu edhe... Jo e kanë formu, po kanë punu në radiotelevizionin e Kosovës në ato aktivitetet e muzkës, kështu këta kanë formu kore, kanë formu orkestër, kanë kenë instrumentalista e tjera, e tjera... Prandaj po them, burimi i kulturës është këtu, ka rrjedhë prej Prizrenit. Prizreni i ka, i ka frymëzu njerëzit për me vazhdu punën në pikëpamje të kulturës, kështu që shkolla e muzikës e Prizrenit është e njoftun në Kosovë. Mandej u formu edhe në Gjilan, u formu edhe në Ferizaj e Prishtinë, po dihet mandej ato ku ishin...

Irvin Jaha: Fillesat i ka marrë prej Prizrenit?

Xheladin Kastrati: Po, veç Prizreni është ai që ka dhonë... edhe nëpër këto shkollat e Kosovës janë nxanësit e Prizrenit kanë dhonë mësim, nxanësit e Prizrenit janë bo drejtorë e tjera, e tjera, po them prej ktuhit është rrjedha e kulturës, mirëpo...

Irvin Jaha: E përmendët që e keni...

Xheladin Kastrati: Mandej si të thashë për “Agimi”-n, ”Agimi” është shoqnia më e vjetër e Prizrenit, Shoqnia Kulturore Artistike e Prizrenit në të cilën sefte kanë marrë pjesë edhe shqiptarët kemi pasë edhe anëtarë sërëbë edhe anëtarë turq që kanë marrë pjesë me instrumentet e veta e tjera, e tjera, mirëpo pjesa kryesore e tyre ka qenë prej kombësisë, prej fesë katolike sepse ishin... Prej kishë kanë ardhë edhe kanë fillu këtë Shoqninë Kulturore Artistike “Agimi”. Keni m’u çuditë kur e shifni ju ni fotografi që e ka... të Shoqnisë Kulturore Artistike “Agimi” në Beograd e cila i ka mahnit krejt publikun. M’falni pak se njeriu pak po...

Irvin Jaha: Jo, jo, s’është problem.

Xheladin Kastrati: Nale pak {shfleton dokumente}.

Irvin Jaha: Jo, jo let vazhdon ai. S’ka problem.

Xheladin Kastrati: *Elbete, durdurursun* [turqisht - për çdo rast ndale].

“O trima luftëtarë”, e, “Për mëmëdhenë,” e tjera, e tjera. “Kur bjen Kushtrimi në Kosovë” e bajagi ishin do kongë që s’i kish ni publiku bajagi moti, kur kanë dalë publiku prej salle t’u kajtë kanë dalë, mirëpo këtë regji e ka pas bo Mark Krasniqi, regjinë e koncertit me gjashtë çiftelia e sharkia edhe gjashtë recitator edhe kori “Agimi”-t edhe ato e ke fotografinë e kom me pa por fotografia gazetareske që thonë, në gazetë ato janë pak a shumë të padukshme mirë, edhe u mbledh “Agimi”... Ky Komiteti, “Qysh ju me formu vetëm shqip?” E tjera, e tera...

Në atë moment ka reagu kryetari i asaj kohe, ka qenë Halit Sahiti drejtor i bankës edhe Engjëll Berisha që më kanë dal zot e kanë thonë se, “Programin s’e ka bo veq Xhela, po programin e kemi bo na krejt bashkarisht qëtu edhe Shoqnia Kulturore Artistike është e shqiptarëve e shqiptart knojnë shqip. Kurse për me knu serbisht e kanë Shoqnia Kulturore ‘Buducnost’-i e kanë shoqninë e vet le të knojnë ata, le të bojnë çka të dojnë, kurse na këtu e kemi shoqninë tonë edhe ‘Dogru Yol’-i e ka shoqninë e vet”, po na e mirshim edhe ka njo... Tollgën, Tollga knojke turqisht, e përcjellke orkestri jonë. Nuk u konë naj problem ajo. Mirëpo kjo nifar tendence e vogël se mandej nuk e bonë të madhe atë punë, u shujt ajo punë. Qato e maj mend si pak kanë reagu këta të partisë në atë kohë, këta të serbisë e tjera, po u shujt ajo mo nuk pat’ asi situatash.

Irvin Jaha: Mirë. E “Zambaku i Prizrenit” mas suprimimit të autonomisë a ka pasë zhvillim, a ka pas festival? A ka vazhdu festivali apo...

Xheladin Kastrati: Festivali osht’ t’u vazhdu gjithmonë, por jo në atë pikëpamje si të thashë parës, nuk është në “Agim”, po është zambakun që e merr nji njeri i cili e merr me, me... Si thojnë, me tender edhe e formon orkestrin, e pagun orkestrin dikuj ku e merr, radiotelevizioni i Prishtinës apo të Prizrenit e tjera, e tjera... Edhe vazhdon Zambaku, është t’u vazhdu, ky është i 28-ti Zambak sivjet që u kry. Domethon nuk ka pasë ndërpreme të Zambakut kurrë, por Zambaku nuk osht’ ai Zambak që ka

qenë përpara, tash është kryekëput me kangë të komponume edhe ato kangë të komponume a po kanë sukses a jo? “Ti djalin tem merre. Ti merre çikën teme”. Jo anena-knena, ka bo vaki kanë knu dy vllazën bineq kanë knu të cillët totalisht nuk kanë pasë vesh sepse e kanë pagu njerin për me i futë femijët aty..

Por në kohën tonë janë shoshitë ata që kanë pasë me dalë para publikut, nuk kanë mujtë me dalë gjithkush, se dirigjenti s’ka lonë, ai jarani u konë... Provat jonë konë të përditshme edhe prova të gjata edhe kur kemi dalë para publikut s’jemi koritë, nuk kemi qitë çka mos, po tash po bojnë vaki ti mu e unë e njoh të tondin e ti e njeh të temin e anej knena. “Agimi” s’e ka hupë autoritetin, “Agimi” ka mbetë qaj Agim që është me të gjitha ato virtytet që i ka por dulë nifar zënke qetash, “Jo u da ‘Agimi’”, e s’u da, “Agimi” nuk është da, “Agimi” osht’ t’u punu, “Agimi” po punon, “Agimi” ka orkestrën, “Agimi” e ka folklorin, “Agimi” i ka anëtarët aty po disa që dojnë unë me marrë e me..

Ti nëqoftëse don me ardhë në Agim, merre instrumentin, nëqofëse je instrumentalist, hyn në orkestër, u kry puna. Në qofë se je këngëtar, merre mikrofonin, dil e kno, u kry puna. Kërkush nuk të thotë jo. Domethonë “Agimi” ekziston si Agim me plot kuptimin e fjalës. E tash individët qesin pak anena e pak knena... Ato as s’duhet me i përmend ato gjëra.

Irvin Jaha: E çka keni bo gjatë viteve të ‘90-ta, a keni vazhdu ende me u marrë me muzikë, a keni pasë vend ku me bo shoqërinë e “Agimi”-t?

Xheladin Kastrati: Po, unë kam punu deri sa kam dalë në pension jom kon në shkollë të muzikës. Mo në Agim nuk kom shku sese drejt me thonë s’po kam qef juve me ju ngarku, mu m’kanë marrë këtu në oborr m’kanë lidh sërëbët, m’kanë lidhë e m’kanë qitë në Shqipni, natën m’kanë qitë. Aty nejta nja dy muaj, më hupi lidhja, familja nuk e dishin ku jom, këtu familja mu m’kanë qitë anena...

Manena ditën e parë mas çlirimit jom ardhë me forcat e NATO-s, jam hi mrena këtu në Prizren edhe fatmirësisht fillova prapë me punu në shkollë të muzikës deri sa erdh momenti me dalë në pension. Kolektivi i shkollës muzikës m’kanë respektu shumë, m’i kanë dhan orët si i kom mbajtë deri kohët e fundit edhe me ju thonë të drejtën s’po thom ma pak veq pesëdhjetë përqind janë profesorat në shkollë të muzikës ish nxanësat e mi të cilët kanë shumë respekt ndaj meje, asni koncert nuk bohet pa më thirrë, kështu që ka mbet nifar lidhje po...

Irvin Jaha: E mbajnë ende respektin ndaj jush..

Xheladin Kastrati: Po (qeshë). Po, edhe djalin e pata këtu se ai e ka kry shkollën e muzikës në violinë gjashtë vjet këtu, jo gjashtë po dhetë vjet, mandej shkoi në Akademi atje, po në ndërkohë e ndërroi pak profesionin, e murr klarinetën e saksafonin, tash është muziqar është edhe ai. Çika e djalit është flautiste, e ka kry shkollën e ulët në flautë gjashtë vjet, kështu që pak në shpi nuk e lo unë pa u ni muzika, era e muzikës m’i ardhë këtu (qeshë). Çka me bo...dhe ende kaniherë po punoj, i kam nja dy-tre nxanësa të shkollës së ulët tetë–nëntë vjeç që vijnë te unë, unë i maj orë të violinës, mos të thom që po punoj për pare, për nder jo, veç po knaqna kur fëmijët kur po i kapin violinat të vegjël edhe të bukur, edhe me ata bile me ma pa hajrin dikush.

Irvin Jaha: Po e kujtoni ende edhe kohën e kalume çka keni bo.

Xheladin Kastrati: Po, po qashtu që jemi konë edhe na në qat’ nivel. Unë në Prizren drejtën me të thonë jam i njoftun bajagi, nuk jam i panjoftun, me thonë drejtën kemi shku edhe nëpër darsma na, ka

ra te ti dasma kemi marrë instrumenta, “Po shkojmë, po shkojmë p’e bojme ni darsëm”. Kemi bo dasma.

Irvin Jaha: Keni bo muzikë edhe nëpër darsma domethonë?

Xheladin Kastrati: Po kemi bo, qysh jo.

Irvin Jaha: Në kuadër të shoqërisë a po?

Xheladin Kastrati: Po, në kuadër të shoqnisë, me orkestër të shoqnisë. Po kemi bo, mirëpo kur po plaket njeri mandej po ndërrohen situata, po ndërrohen njerëzit, po ndërrohen... pleqnia p’e bon të vetën. Tash unë s’muj me ardh me ty në orkestër, ose se e keni shoqinë tonde ai tjetri e ka të vetën, jo qashtu... Mirëpo shumë është karakteristike që në shoqni të Agimit po them kanë ardhë edhe serbë i kanë ra gitarës e kanë përcjellë orkestrën, s’kemi pasë gitarist tonin, e kemi marrë prej “Budučnost”-it, ka bo prova me neve, ka dalë në koncert me neve, kurrë nuk është ni një fjalë e randë e tjera. Kanë ardhë turqit kanë knu në gjuhën turke ose me gjymysh, jemi knaqë si me pas kon anëtarë të “Agimi”-t, tash po ni, jo po ni po tash jemi largu edhe ata janë largu me një anë na me ni anë, nifar, nifar ftoftësie, ni gjendje që thojmë e ftoftë, po jo veç mes kombeve po edhe mrenda në shoqni aty, jo u da “Agimi”... Po ku u da “Agimi”? Çka ka pasë me da “Agimi”? S’është pasunia kërkuj ajo, shkon knon, rri me shokë, pi një çaj, një kafe edhe u kry puna. Po ata janë t’u dhonë koncerte, e kanë edhe programin e tona të mirat i kanë po na pleqtë po duhet me nejtë pak anash.

Irvin Jaha: Vetëm edhe diçka për “Agimi”-n se nuk e kemi cekë, a keni marrë pjesë edhe jasht kufive të shtetit Jugosllav apo vetëm për vende të Jugosllavisë?

Xheladin Kastrati: Shumë mirë e ke çelë. “Agimi” është shoqni me t’thonë që prej ‘44-shit e deri tash është bajagi ni kohë e gjatë, na kemi shku me dhonë koncert edhe në burg të Nishit për shqiptarët, në burg të Nishit kemi shku! Se në Turqi disa herë kemi shku me dhonë koncerte.

Me 1972-shin që s’kanë mujtë as zogjët me kalu kufinin, na kemi shku në Shqipni, kemi dhonë 24 koncerte edhe na kanë pritë si ma s’miri, domethonë na s’kemi pa gjë të keqe. Për shembull në Stamboll e anena, Kirsehir, Aksehir jemi konë me shoqinë e “Agimi”-t, një javë ditë teposhtë e, dy-tri herë kemi shku ka një javë me dhonë koncerte nëpër Stamboll e nëpër vende t’ndryshme.

Irvin Jaha: E pasi që e përmendët Shqipërinë, çka keni mendu për Shqipërinë e asaj kohe, si ju ka dokë?

Xheladin Kastrati: Po koha e shkëlqyshme po të them, kohë e cila nuk ka leju me dallu kombi-kombin, ky shqiptar, ky turk, ky ai e ky anej na po të them jemi si me na pas bo një nonë, na s’kemi përmendë këto ndamjet nacionale kurrë, sidomos në Agim kjo s’është ni kurrë. Mirëpo tash kohët e fundit jo veç në Agim, tash gjithkund është bo kjo ndamje, kjo ftohje kësi soji, megjithëse vjen t’u u përmirësu situata se arti i bashkon njerëzit.

Me ni darsëm po ni tash në Kosovë këtu në Prizren, në rreth Prizrenit kanë ardhë disa serbë prej Serbie i kanë thirrë mysafirë, u çun po kcejnë barabartë me shqiptarët, edhe të zotit e darsmës kanë kcy as s’e kanë marrë vesh që ka dikush i huj aty deri sa ka kallxu i zoti i dasmës se, “I kom do qështu, qështu mysafir”... Po të thom, te na popull ma të urtë, ma dashamirë se në Kosovë, në Prizren nuk ki. Fatmirësisht ju e dini Prizrenin, marrim çika, japim çika, turiqsht e shqip e nuk të vetë kush, a është

terbieli [turqisht - e sjellshme], a ka edukatë, a ka kulturë? Po, u kry puna. A nëpër vende tjera pak është ndryshe, më gjithëse s'po flasim për ato po...

Irvin Jaha: Vetëm në Turqi keni pasë koncerte jashtë vendit, kështu nuk keni pasë në vende tjera a po...? Jashtë, jashtë...

Xheladin Kastrati: Në Itali jemi konë, në, në po të thash në Shqipni, në Itali, besa mas meje kanë shku edhe në vende tjera po unë nuk jom shku atëhere. Në Itali kam qenë edhe unë, me ta kemi nejtë nja pesë ditë atje ne Itali kemi dhonë nëpër organizata të ndryshme tyne ku ishin shqiptarë ma tepër për me ni pak muzikën tonë. Në Slloveni jemi kon gjithashtu.

Irvin Jaha: Si ju kanë pritë atje?

Xheladin Kastrati: Mirë, shumë, shumë mirë. Italia, po Evropa është ajo... Gjermania, dy-tre herë jemi konë në Gjermani është Bingeni është qyteti që është i lidhun me Kosovën, t'u e marrë rrushin e Rahovecit e tjera këto anë tregtie. E na jemi shku gjithmonë për me çelë këtë festivalin e venës ku është n'Gjermani, Bingen, Mainz edhe Bingen. Kështu që drejtë me t'thonë s'pi maj mend edhe ato shumë shtete ku jemi konë, veç "Agimi" bajagi ka shetitë nëpër shumë vende edhe n'Allzhir ka shku "Agimi", n'Algeri.

Irvin Jaha: A keni naj kujtim të veçantë prej ktyne udhëtimeve nga jashtë?

Xheladin Kastrati: Prej?

Irvin Jaha: Prej udhëtimeve që i keni bo jashtë vendit?

Xheladin Kastrati: Po kemi syreta¹, kemi fotografi e i kemi ato gjana që s'kemi mujt me...

Irvin Jaha: Po kështu naj kujtim diçka interesant çka ju ka ndodhë rrugës apo diçka që mundet m'u veçu?

Xheladin Kastrati: Jo, nuk ka asi soji, po ishte interesant kur na kanë çu neve në Turqi m'i pa ato shpellat në Aksehir-Kirsehir atje në ato shtëpiat në guri mrenda ..

Irvin Jaha: Shpellat?

Xheladin Kastrati: Shpellat ku kanë jetu njerëzit, ku janë vorrosë në ato vende e tjera, e tjera. Ato janë kujtim i gjallë sepse s'kishim pa kurrë tjetër kund, tash p'i shofim, mirëpo atëhere vet shumë vende të mira shumë interesant edhe populli si popull na kanë prit shkëlqyshëm, po po vjen koha po ftofesh se...

Irvin Jaha: Interpretimin e muzikës krejt e keni bo në gjuhën shqipe?

Xheladin Kastrati: Po, po edhe turqisht edhe shqip i bojshim na ato, kemi pasë shokë na hala i kemi gjitha shokë ne, hala na nërmjet veti njifemi, ftohem, e thirrë sonte me gjymysh, t'vjen knaqesh me to,

¹ Në zhargonin prizrenas syret - fotografi. Fjala syret rrjedh prej fjalës turke *seyret* që do të thotë shiko.

knon turqisht i mshon edhe ti violinës bashkë me ta, kjo është punë që veç në Prizren janë këto gjana, rrallë i ki tjetër kund, rrallë i ki tjetër kund.

Irvin Jaha: E ka mbajtë Prizreni atë dashni ndaj tjerëve nuk e ka hupë.

Xheladin Kastrati: Po, po, po. S'kanë thonë po them kryeqyteti i kulturës, historik i Kosovës, kryeqyteti... veç u konë deshtë me thonë kryeqyteti historik edhe i kulturës, se kultura numër një është Prizreni. Kur u kon Prizreni ka pasë orkestrin e, e esnafëve në atë kohë, kohën e Turqisë domethonë në Kosovë s'ka pasë kërkush asi orkestre.

Irvin Jaha: Në Prizren.

Xheladin Kastrati: Po Prizreni ka pasë, do kanë pas ardhë turq me ato kapuqat, fesat e zi, me tesha të kohës së osmanlive edhe aty ka pasë edhe shqiptarë, nuk jonë konë veç turqt. Kështu që po thom, burimi i kulturës është me të vërtetë Prizreni, kur Prizreni ka pasë atje dikush u konë larg me kulturë... Po unë me gjithë qef ju kisha ofru çka të ju kona qefi çka të duhet, nëqoftëse keni nevojë m'i pa qëto diplomat e mia qëto sende mirë kishit bo, a keni prapë hala diçka me pytë...

Irvin Jaha: Jo, une pytje nuk kam mo. Kështu, faleminderit shumë për intervistën, ishte kënaqësi...

Xheladin Kastrati: Faleminderit, po unë nashta pak edhe kom lonë disa gjana, po njeri s'po i mbanë mend të gjitha kto, kjo është ni lëpezë e gjanë, e madhe, "Agimi" e shkolla jeme, pjesëmarrjet nëpër festivale e nëpër tjera ka bajagi *mesele* [turqisht - tregim]. Mirëpo hallall i koftë popullit tem çka i kom dhonë mundin se edhe ma kanë shpërbly atë mundin. Nxanësit e mi gjithmonë kanë dalë faqebardhë kudo që kanë shku. Sot në orkestrën simfonike të Prishtinës janë katër-pesë nxanësa të mi që kanë qenë nxanësat e mi në shkollën e muzikës në Prizrenit edhe po mburret njeri me suksesin e tyne. Kështu që mudi nuk hupet por kur nuk punon nuk t'lëvdon kërkush po kur punon atëhere ti je i njoftun dikun-dikun ...

Irvin Jaha: Faleminderit shumë për intervistë!

Xheladin Kastrati: Faleminderit prej juve që e keni marrë këtë iniciativë për me ardhë me pi ni kafe me mu me bo pak muhabet bashkë, moti s'kam bo ksi muhabeti.

Irvin Jaha: Pak edhe kujtimet...

Xheladin Kastrati: Kujtimet po, pak po preket njeri edhe pak prej nostalgjisë po prekesh pak...